

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA LUSHNJE

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale, Neni 248 "Shpërdorimi detyrës".

KUNDER: [REDACTED]

DREJTUAR: PROKURORISË PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
LUSHNJE

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 , si dhe neneve 248 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, dhe 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijëni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Çdo person që ka marrë dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

1.2. Nga ana tjetër Kodi Penal në dispozitat e tij parashikon se: